



Njihni të drejtat tuaja

Koalicioni për Mbrojtjen e Emigrantëve dhe Refugjatëve në
Massachusetts

Rreth MIRA-s:



Programet:

- Mbrojta dhe organizimi
- Ndhmë në aplikimin për shtetësi
- Angazhimi qytetar

Vizioni ynë është një Komonuelth dhe një komb, ku *të gjithë* mund të përparojnë, pa marrë parasysh se nga ku kanë ardhur apo si kanë ardhur këtu, si dhe ku *të gjithë* mund të marrin pjesë plotësisht në jetën sociale, ekonomike dhe qytetare të komunitetit të tyre.





Përmbledhje e shkurtër e shërbimit të kontrollit të emigracionit

Sistemi i emigracionit: Departamenti i Sigurisë Kombëtare



**Shërbimi i
kontrollit të
emigracionit
dhe doganave**

Policia e
emigracionit:
kontrolli, ndalimi
dhe dëbimi, që
përfaqëson DHS-
në në procedurat
e emigracionit

**Dogana dhe
mbrojtja e
kufijve**

Kontrolli në kufi
dhe brenda 100
miljeve nga kufiri,
në pikat e
kontrollit dhe
portet e hyrjeve

**Shërbimet e
shtetësisë dhe
emigracionit në
SHBA**

Gjykojnë
petitionet për
përfitimet e
emigracionit (azil,
green card,
shtetësi, viza
speciale)

Si njerëzit mund të vijnë në kontakt me shërbimin e kontrollit të emigracionit



U.S. Citizenship
and Immigration
Services

- Kontakti me sistemin penal
- Aplikimi për një përfitim në USCIS, ndërkohë që keni një urdhër largimi ose kallëzim penal
- Mbajtësit e green card-it që kthehen nga udhëtimi
- Bastisjet dhe kontrolli i synuar
- Rrethana të tjera të kufizuara



Arsyet e dëbimit



Mungesa e statusit të ligjshëm

Bazat penale, duke përfshirë:

- Pothuajse të gjitha dënimet për drogë
- Dhuna në familje, shkelja e urdhrit të mbrojtjes
- Vjedhja, mashtrimi dhe shumë më tepër!

Ndonjëherë, veprat relativisht të vogla dhe jo të dhunshme mund të çojnë në dënim të detyrueshëm, edhe për mbajtësit e green card-it!

Shkeljet e emigracionit / Mashtrimi

Bazat e lidhura me sigurinë (përfshirja në banda, terrorizmi)



Kush rrezikon të dëbohet?

- Çdokush që nuk është shtetas i SHBA-së mund të jetë i cenueshëm nëse ka bazë dëbimi, si për shembull akuza penale ose një urdhër paraprak dëbimi.
 - Emigrantët e paautorizuar / pa dokumente
 - Personat me status azili ose refugjati ose ndonjë formë tjetër mbrojtjeje
 - Banorët e përhershëm të ligjshëm (mbajtës të green card-it)
 - Joemigrantët (vizitorë, studentë etj.)





Njihni të drejtat tuaja
në ndërveprimet me shërbimin e
kontrollit të emigracionit

Të drejtat themelore



- Të gjithë që jetojnë në SHBA kanë disa të drejta themelore sipas kushtetutës së SHBA-së, pavarësisht nga statusi i emigracionit
- Është e rëndësishme t'i ushtrojmë këto të drejta dhe të mbrojmë të drejtat tona themelore



Karta e të drejtave



<https://www.ilrc.org/red-cards>

Infografikë shumëgjuhësh për përdorimin e kartës së të drejtave

- Ushtrimi i të drejtës për të heshtur mund të jetë i vështirë.
- Është e dobishme për njerëzit që të kenë një kartë të të drejtave në portofol, të cilën mund ta nxjerrin dhe t'ua japin agjentëve të emigracionit ose policisë.




Nëse autoriteti i emigracionit ju vjen në shtëpi...




Mos e hapni menjëherë derën:

- Ligjërisht, nuk jeni të detyruar të hapni derën, përveç nëse oficeri ju jep urdhër të nënshkruar nga një gjykatës.
- Kërkojuni oficerëve të identifikohen (agjencia, emri, ID-ja)
- Pyetni nëse kanë **urdhër** të nënshkruar nga një gjykatës
- Nxirrni kartën "Njihni të drejtat tuaja" nën derë
- Ju keni të drejtë të heshtni dhe të kërkonit një avokat. Nëse vendosni ta ushtroni atë, deklarojuni oficerëve se "Unë kërkoj të drejtën time për të heshtur dhe për një avokat".
- Thirrni një mik ose familjar që njëkohësisht është shtetas amerikan ose një avokat



Kur mund të hyjnë forcat e rendit në shtëpinë time?



Urdhëresat



Shembull i urdhrit të nënshkruar nga një gjykatës

AD-102 (Rev. 01-09) Search and Seizure Warrant

UNITED STATES DISTRICT COURT
for the
Southern District of California

In the Matter of the Search of)
(Briefly)
or later,) and)
2043 Raymond Avenue)
San Diego, California)
Care No.)
'14 MJ 0 396

SEARCH AND SEIZURE WARRANT

To: Any authorized law enforcement officer

An application by a federal law enforcement officer or an attorney for the government requests the search of the following person or property located in the Southern District of California
(Identify the person or describe the property to be searched and give its location)
See Attachment A-2.

The person or property to be searched, described above, is believed to conceal (Identify the person or describe the property to be searched)
See Attachment B-2.

I find that the affidavit(s), or any recorded testimony, establish probable cause to search and seize the person or property.

YOU ARE COMMANDED to execute this warrant on or before February 14, 2014
(not to exceed 10 days)

☒ in the daytime 6:00 a.m. to 10 p.m. ☐ at any time in the day or night as I find reasonable cause has been established.

Unless delayed notice is authorized below, you must give a copy of the warrant and a receipt for the property taken to the person from whom, or from whose premises, the property was taken, or leave the copy and receipt at the place where the property was taken.

The officer executing this warrant, or an officer present during the execution of the warrant, must prepare an inventory as required by law and promptly return this warrant and inventory to United States Magistrate Judge Hon. David H. Bartick (Name)

☐ I find that immediate notification may have an adverse result listed in 18 U.S.C. § 2705 (except for delay of trial), and authorize the officer executing this warrant to delay notice to the person who, or whose property, will be searched or seized (check the appropriate box) ☐ For _____ days (not to exceed 30).

Until, the facts justifying, the later specific date of _____.

Date and time issued: 1/14/2014 3:54 PM [Signature]
Judge's signature

City and state: San Diego, California Hon. David H. Bartick, U.S. Magistrate Judge
Printed name and title

Shembull i urdhrit të emigracionit: nuk i jep
leje autoritetit të emigracionit për të hyrë në shtëpi

U.S. DEPARTMENT OF HOMELAND SECURITY Warrant for Arrest of Alien

File No. _____
Date: _____

To: Any immigration officer authorized pursuant to sections 236 and 287 of the Immigration and Nationality Act and part 287 of title 8, Code of Federal Regulations, to serve warrants of arrest for immigration violations:

I have determined that there is probable cause to believe that _____ is removable from the United States. This determination is based upon:

- ☐ the execution of a charging document to initiate removal proceedings against the subject;
- ☐ the pendency of ongoing removal proceedings against the subject;
- ☐ the failure to establish admissibility subsequent to deferred inspection;
- ☐ biometric confirmation of the subject's identity and a records check of federal databases that affirmatively indicate, by themselves or in addition to other reliable information, that the subject either lacks immigration status or notwithstanding such status is removable under U.S. immigration law; and/or
- ☐ statements made voluntarily by the subject to an immigration officer and/or other reliable evidence that affirmatively indicate the subject either lacks immigration status or notwithstanding such status is removable under U.S. immigration law.

YOU ARE COMMANDED to arrest and take into custody for removal proceedings under the Immigration and Nationality Act, the above-named alien.

(Signature of Authorized Immigration Officer)

(Printed Name and Title of Authorized Immigration Officer)

Certificate of Service

I hereby certify that the Warrant for Arrest of Alien was served by me at _____ (Location)

on _____ (Name of Alien) on _____ (Date of Service), and the contents of this notice were read to him or her in the _____ (Language) language.

Name and Signature of Officer

Name or Number of Interpreter (if applicable)

Form I-201 (Rev. 08/14)

Patentat e shoferit



DUHET: të drejtoni makinën vetëm me patentë të plotë shoferi, jo me leje

PËR TË DREJTUAR MAKINËN me leje, duhet të keni dikë në makinë që:

- 1) Ka drejtuar makinë për 1 vjet
- 2) Është mbi moshën 21 vjeçare
- 3) Është ulur pranë shoferit

Nëse ju ndalojnë gjatë vozitjes...



Nëse jetoni në Massachusetts, keni të drejtë të merrni patentën e shoferit pavarësisht statusit të emigracionit!

- Qëndroni në makinë. Vendosni duart në timon, që t'i shohë oficeri.
- Ju nuk jeni të detyruar t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje, por sho duhet të japë emrin dhe adresën. Tregoni kartën "Njihni të drejtat tuaja".
- Policia mund të kontrollojë makinën tuaj, nëse ka arsye të të besuar se jeni përfshirë në një krim




- **DEKLARONI QARTË SE NUK JEPNI PËLQIMIN PËR KRYERJEN E KONTROLLIT**

- **Mos jepni dokumente të rreme**

Nëse autoriteti i emigracioni ose policia ju ndalon në publik...



- Ruani qetësinë, mos vraponi dhe mos i rezistoni arrestimit!
- Pyetni nëse jeni i arrestuar apo i lirë për t'u larguar.
- **Heshtni dhe thoni se doni të flisni me një avokat.**
- Nëse nuk jeni të arrestuar, keni të drejtën të mos jepni gjurmën e gishtit.
- Policia mund t'ju kontrollojë nëse ka dyshime të arsyeshme se jeni të armatosur dhe të rrezikshëm.
- Nëse keni dokumente të vlefshme emigrimi dhe jeni mbi 18 vjeç, ligji ju kërkon t'i mbani ato dokumente me vete.
- Ju keni të drejtën për një avokat. Kërkoni t'i telefononi një avokati.



Mos jepni kurrë dokumente të rreme!

Si të përgatiteni



- Njihni të drejtat tuaja në rast se një oficer ju bën pyetje ose vjen në shtëpinë tuaj.
- Mësoni përmendësh numrat e telefonit të anëtarëve të familjes suaj dhe/ose të një avokati/organizate që i besoni. **Kur të jeni në paraburgim, mund të keni mundësi të kryeni vetëm një telefonatë!**
- Mendoni për një shtetas amerikan ose dikë me status emigrimi, të cilit i besoni e që mund të paguajë garancinë nëse ju jepet mundësia e këtillë nga një gjykatës emigracioni.



Arrestimi dhe ndalimi

- Nëse jeni arrestuar ose ndaluar, **MOS**:
 - Nënshkruani asgjë dhe mos pranoni "largim vullnetar", pa udhëzimin e një avokati
 - U mbështetni te agentët e emigracionit për t'ju ofruar informacion në lidhje me të drejtat tuaja; pyetni një avokat për faktet.
- Ju keni të drejtë:
 - **Të heshtni.**
 - Të telefononi një avokat ose një familjar
 - Të vizitoheni në paraburgim nga një avokat
 - Të kontaktoni konsullatën tuaj



Ju mund të përdorni **lokalizuesin e të paraburgosurve në internet** për të gjetur dikë që është ndaluar nga emigracioni



Lirimi me garanci

- Shërbimi i kontrollit të emigracionit mund të zgjedhë t'i vendosë në paraburgim emigracioni individët që po përpiqet t'i dëbojë
- Nëse ndalohen, shumë individë mund të kërkojnë lirim me **garanci** derisa çështja e tyre është në pritje.
 - Ju mund t'i kërkonit gjykatësit të emigracionit të rishikojë vendimin e garancisë
 - Ndiemon për të treguar lidhje të forta familjare dhe me komunitetin
 - Vetëm dikush që është shtetas amerikan ose ka status të ligjshëm emigrimi duhet të shkojë në emigracion për të paguar garancinë



Njihni të drejtat tuaja: Përgatitja e familjes


Të drejtat prindërore



- Ju keni të drejtë të merrni vendime për fëmijët tuaj, pavarësisht nga statusi i emigracionit
- Ju nuk jeni të detyruar të jepni informacion për fëmijët tuaj, por është mirë t'i tregoni autoritetit të emigracionit se nëse jeni kujdestari kryesor.
- Ju keni të drejtë të merrni masa për kujdesin e fëmijës suaj.
 - Ju mund të kërkonti një telefonatë në momentin e arrestimit dhe mund të pyesni se si do të mund të kontaktoni me fëmijët tuaj
- Nëse fëmijët tuaj janë në sistemin e familjeve përkujdesëse, ju keni të drejtë të merrni pjesë në procedurat e mirëqenies së fëmijëve nga paraburgimi dhe pas dëbimit, përveç rasteve kur ju janë ndërprerë të drejtat prindërore
 - Ndalimi dhe dëbimi nuk përbëjnë braktisje



Përgatitja e familjes



Paketa e përgatitjes së familjes në Massachusett
Plani i përgatitjes së familjes i Boston Medical Center
Përgatitja e familjes në shtete të tjera



Përgatitja e familjes

- Çfarë është plani i gatishmërisë së familjes?
 - Një mjet që mund t'ju ndihmojë të merrni vendime të mirinformuara se si të kujdeseni për familjen tuaj
 - Plan mbrojtjeje, që u ofron prindërve dhe kujdestarëve që përballen me kërcënimin e ndalimit ose dëbimit, mundësinë për të marrë vendime për:
 - Atë se kush do të kujdeset për fëmijët në mungesën tuaj
 - Planet për plotësimin e nevojave arsimore, mjekësore dhe emocionale të fëmijës në mungesën tuaj
 - Planet për ribashkim



Bërja e një plani

Përditësoni kontaktet e shkollës: sigurohuni që të keni informacionin e saktë të kontaktit për disa njerëz të cilët keni besim që të marrin fëmijën tuaj nga shkolla, në rast se ju nuk mundeni. Tregojini shkollës që nuk pranoni të përfshihen në asnjë informacion drejtorie që nxjerr shkolla, me qëllim të mbrojtjes së informacionit tuaj.

Regjistroni lindjen e fëmijës suaj në konsullatën e huaj: nëse fëmija juaj dëshiron të udhëtojë ose të zhvendoset në shtetin amë, mund të jetë më e lehtë nëse lindja e tij është regjistruar tashmë në konsullatë.

Aplikoni për pasaporta për fëmijën v: shumica e qeverive kërkojnë që të dy prindërit të japin leje që fëmija i tyre të pajiset me pasaportë. Nëse vetëm ju keni kujdestarinë ligjore ose një urdhër të caktuar gjyqate, nuk keni nevojë për lejen e prindit tjetër.

Shkruani një letër udhëtimi: nëse fëmija juaj duhet të udhëtojë jashtë SHBA-së, mund të ketë nevojë për një letër të noterizuar që i jep leje të udhëtojë me një të rritur të besuar. Është mirë të kontaktoni një linjë ajrore ose konsullatë për të marrë udhëzime të sakta.

Alternativë joformale



- të flisni me njerëzit që dëshironi të kujdesen për fëmijën tuaj ose të shkruani se çfarë dëshironi të ndodhë në rast urgjence
- më e lehtë, por nuk i jep të drejta ligjore kujdestarit dhe shkolla ose mjeku i fëmijës mund të mos e ndjekin planin tuaj

Deklaratë për autorizimin e kujdestarit



- i jep kujdestarit të drejtën të marrë vendime për kujdesin shëndetësor dhe arsimimin e fëmijës suaj deri në 2 vjet
- Prindi ruan të gjitha të drejtat dhe mund t'i japë fund në çdo kohë
- Kërkon nënshkrimin e prindit dhe të 2 dëshmitarëve, e noterizuar

Autorizimi i agentit të përkohshëm



- lejon "agjentin" ose personin që ju zgjidhni, të marrë çdo vendim që një prind mund të marrë (përveç martesës dhe birësimit) për fëmijën tuaj, duke përfshirë pronën dhe financat
- I vlefshëm për 60 ditë pasi të hyjë në fuqi, por mund të rinovohet
- Të dy prindërit duhet të nënshkruajnë, nëse janë në gjendje
- Duhet të nënshkruhet nga agjenti dhe 2 dëshmitarë

Kujdestaria



- kujdestari ligjor ka të gjitha të drejtat që ka një prind, por i ushtron këto të drejta në vend të prindit
- duhet të merret përmes gjykatave

Dokumente të rëndësishme



- Është shumë e rëndësishme të ruani të gjitha dokumentet e emigracionit dhe të siguroheni që asnjë faqe të mos humbasë.
- Shumë dokumente kanë numrin e identitetit të emigracionit (fillon me shkronjën A dhe ka 8 ose 9 shifra)
- Disa dokumente kanë data për seancat dëgjimore ose takime të tjera të emigracionit dhe këto data janë shumë të rëndësishme!





Qasja në përfitime dhe barra publike

Konkluzionet kryesore



- Prindërit emigrantë **mund të aplikojnë gjithmonë** për shtetësi amerikane për fëmijët, edhe nëse prindi nuk i plotëson kushtet!
 - Prindërit nuk kanë nevojë për numrin e sigurimeve shoqërore ose dëshmi të statusit të **imigrimit** për të aplikuar për fëmijët, por prindi duhet të verifikojë të ardhurat e tij.
- Nuk ka nevojë të jeni shtetas amerikan për të marrë përfitime
- Sipas rregullit aktual, nuk ka pasoja emigracioni për aplikimin ose marrjen e përfitimeve të tjera, përveç ndihmës me para me dorë për mirëmbajtjen e të ardhurave dhe kujdesit afatgjatë në shtëpi të pleqve
- Agjencitë shtetërore të përfitimeve dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në Massachusetts **nuk i raportojnë** emigrantët në ICE

Rregulli i barrës publike



Shumë emigrantë NUK i nënshtrohen testit të barrës publike.

ZBATOHET PËR:

Emigrantët që aplikojnë për green card (qëndrim të përhershëm të ligjshëm) ose vizë për të hyrë në Shtetet e Bashkuara.

NUK ZBATOHET PËR:

- Shtetasit amerikanë
- Aplikantët për shtetësi
- Rinovimet e green card-it
- Heqjen e kushteve
- Refugjatët/Azilantët
- VAWA
- Vizat T/U
- Të miturit emigrantë specialë
- Aplikimet ose rinovimet e DACA-së
- Aplikimet ose rinovimet e TPS-së
- Lirimi me kusht në baza humanitare

Përfitimet dhe barra publike



Sipas rregullit aktual, merren parasysh vetëm dy lloje përfitimesh:



- Ndiurma me para në dorë për mirëmbajtjen e të ardhurave
- Institucionalizimi për kujdesin afatgjatë në kurriz të qeverisë



Shumica e njerëzve që përballen me testin e barrës publike, nuk i plotësojnë kushtet për përfitimet në test.

Sipas rregullit aktual, shumica e përfitimeve NUK merren parasysh



Programet e kujdesit shëndetësor, si MassHealth dhe klinikat e komunitetit



Ndihma për qiramarrje, si seksioni 8, RAFT, strehimi me ndihmë emergjente (EA) dhe banesat publike



Programet ushqimore, si SNAP, WIC dhe drekat shkollore



Përfitimet me para në dorë nga puna, si përfitimet e papunësisë, siguria sociale dhe pensionet



Programet me bazë shtetërore, jo me para në dorë

Lista “Përfitimet e sigurta” për Massachusetts: <https://miracoalition.org/wp-content/uploads/2022/10/Massachusetts-Safe-to-Use-Benefits-October-2022.pdf>



A mund të ndryshojë rregulli?

- Rregulli aktual u fut në rregulloret federale dhe u ka mbijetuar kontestimeve gjyqësore
- Administrata Trump mund të përpiqet të rivendosë rregullin e vjetër, por:
 - Edhe rregulli i vjetër zbatohet për një numër të vogël njerëzish
 - Asnjë ndryshim nuk do të hyjë në fuqi menjëherë
 - Çdo ndryshim do të kontestohet nga avokatët e të drejtave të emigrantëve



Njihni të drejtat tuaja: Ku të
merrni ndihmë ligjore

Who can give me advice and represent me in an immigration application or case?



An **attorney (lawyer)** with a valid license to practice law.



An “**accredited representative**” working for a nonprofit organization who has received training and special authorization from the US government to help people with immigration cases. You can look for the organization and the individual on the government’s [listing](#) of accredited representatives.



Notary publics (or “notarios”) are not lawyers in the US and cannot provide legal advice.



Other people like interpreters or tax preparers. Interpreters can help translate important documents sometimes needed for immigration cases and preparers can fill out the form with only the information provided by the applicant, but they cannot provide legal advice.^{3,4}

Çfarë duhet të bëj nëse kam qenë viktimë e mashtrimit?



Mund të bëni një raportim! Kjo mund të ndihmojë në mbrojtjen e të tjerëve dhe gjithashtu mund të ndihmojë në zgjidhjen e situatës suaj. Ju mund të bëni raportime pranë:

- Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Massachusetts: (617) 963-2917 ose https://www.eform.ago.state.ma.us/ago_eforms/forms/piac_ecomplaint.action
- Bordit të Mbikëqyrësve të Avokatisë në Massachusetts: <https://www.massbbo.org/s/complaints>
- Programit për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit të gjykatës së emigracionit (nëse jeni tashmë në gjykatën e emigracionit): (703) 305-0470 ose EOIR.Fraud.Program@usdoj.gov

Burimet ligjore për emigracionin



- **Drejtoria e shërbimeve ligjore në Massachusetts:**
 - Gjetësi i burimeve ligjore në Massachusetts:
<https://masslrf.org/en/home>
 - Lista e shërbimeve ligjore të gjykatave të emigracionit:
<https://www.justice.gov/eoir/file/ProBonoMA/download>
 - Konsultime falas në qytetin e Bostonit:
https://masslrf.org/en/programs/view/boston_immig_clinic
- **Drejtoria e shërbimeve ligjore jashtë Massachusetts:**
 - Drejtoria ligjore e rrjetit të avokatëve të emigracionit:
<https://www.immigrationadvocates.org/legaldirectory/>





Më shumë burime

